





„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Zëvendës kryeredaktor
Lupço Pandilovski

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Perkthyes dhe lektorë
Vladimir Bogdanovski, Behar Dalipi,
Sadije Dalipi, Merita Abdullahi

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:
Evropa 92 - Koçanë



Të nderuar bashkëqytetarë,

Kaluan 100 ditë nga marrja e funksionit Kryetarë i Qytetit të Shkupit, një periudhë kohore gjatë së cilës me transparencë dhe përkushtim si një ekip punuam për zhvillimin e demokracisë në nivel lokal me qëllim të arritjes së një jete më të mirë për bashkëqytetarët tanë. Njëqind ditët e para paraqesin edhe fotografinë e asaj se çfarë do të ndodh deri në fund të mandatit tim.

Gjatë tre muajve të kaluar ia dolëm që me sukses të mbajmë stabilitetin financiar të Qytetit të Shkupit që ka një rëndësi tejet të madhe për funksionimin e pandërprerë të Qytetit. Mirëmbajtja e higjienës komunale si dhe zvogëlimin e kaosit në komunikacion ishin dhe do të mbeten prioritetet tona. Edhe njëherë u organizuam që ta pastrojmë qytetin me qëllim që të ngritet niveli i higjienës në të gjitha komunat e qytetit të Shkupit. Në bashkëpunim me ndërmarrjet publike të Qytetit dhe dhjetë komunat me sukses e realizuam aksionin – “Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbëruar”. Ky aksion përdëftoi se punët në mënyrë ekipore më me sukses realizohen. I pastruam deponitë e egra dhe sipërfaqet e braktisura në të gjitha komunat në territorin e qytetit të Shkupit dhe i zbuluam pikat e zeza të cilat gjatë periudhës së ardhme do të bëhen pjesë e programit tonë punues, me qëllim që t’i fisnikërojmë dhe të jenë në qasje për qytetarët.

Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Ministrinë e transportit dhe lidhjeve tani më kanë shpallur tender dhe kanë zgjedhur shtëpinë

për projekte e cila do të përpiloj studimin për komunikacionin në qytetin e Shkupit. Ky studim do t’i ofroj udhëzimet për gjetjen e zgjidhjeve më efikase lidhur me kaosin në komunikacion. Në këtë drejtim, ne tanimë kemi përfunduar projektin për bulevardin “Makedonska vojska”. Projekti për rinovimin e rrugës “Bllagoja Stevkovski” është në fazë të përgatitjes dhe po presim që filloj në vjeshtë.

Në Qytetin e Shkupit po përgatitet edhe projekti për zgjerimin e rrugës “Përvomajska”, prej semaforëve afër “Usje” në drejtim të vendbanimit Draçevë. Projekti do të zhvillohet në dy faza, prej tramit deri në Fidanishten dhe prej bulevardit “Serbia” deri në Draçevë. Në të njëjtën kohë po punohet në tejkalimin e kontesteve pronësore-juridike në këtë pjesë të rrugës.

Zgjerimin dhe sendërtimin e bulevardit “Serbia” do ta fillojmë në fund të këtij muaji. Me këtë do të zgjidhet një pjesë e madhe e problemeve me të cilat ballafaqohen shkupjanët në komunikacion.

Zgjidhjet e problemeve në fushën e urbanizmit paraqesin një pjesë të prioritetëve tona. Procedura për përpilimin e Planit të ri të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit është në rrjedhë dhe duhet të përgatitet në periudhë prej 18 deri 24 muaj. Filluam edhe me procedurën për sigurimin e dokumentacionit teknik-urbanistik për ndërtimin e varrezave të reja.

Me respekt,
Koce Trajanovski

NJËQIND DITË PËR SHKUPIN

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, me marrjen e funksionit më 13 prill të këtij viti, hapi një front të gjerë, së bashku me këshilltarët e qytetit, Qeverinë e R. Maqedonisë, Komunat, administratën dhe me qytetarët e Qytetit të Shkupit për realizimin e programit – PËR QYTETIN E SHKUPIT: Gjatë 100 ditëve të kaluara janë filluar përgatitjet, procedura dhe realizimi i shtatëdhjetë përqind të programit, të paraparë për vitin 2009 si dhe projektet të cilat në vazhdimësi do të realizohen gjatë katër viteve të ardhshme.

PROJEKTI: SHKUPI – ZGJIDHJE TË REJATË KOMUNIKACIONIT

Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me ministrin e transportit dhe lidhjes nënshkruan tender dhe zgjedhën shtëpinë projektuese IDOM nga Bilbao – Spanja, që do të përpilojë studime të komunikacionit për qytetin e Shkupit.

PROJEKTI: NDRYSHIMI I “PGJU” PËR QYTETIN E SHKUPIT

Filloi procedura për përpilimin e Planit të ri të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit. Procedura për përpilimin e tij duhet të përfundojë në periudhën prej 18 deri më 24 muaj.

PROJEKTI: ON LLAJN – QASJE PËR SHËRBIMET E QYTETIT TË SHKUPIT, PROJEKTI: SERTIFIKATE DIGJITALE PËR E-SHËRBIME, PROJEKTI: PLANIFIKIMI, PËRCJELLJA DHE KONTROLLI I BUXHETIT TË QYTETIT TË SHKUPIT, PROJEKTI: E-KËSHILLI – FAZA E DYTË

Janë ndarë mjete financiare për projektet dhe kanë filluar përgatitjet për realizimin e tyre.

PROJEKTI: LOKACIONI I RI PËR VARREZAT NË QYTETIN E SHKUPIT

Ka filluar procedura për sigurimin e dokumentacionit tekniko - urbanistik për ndërtimin e varrezave të reja.

PROJEKTI: RREGULLIMI I SHTRITËRVETË LUMENJËVE

Tërisht është kositur dhe mbledhur bari në shtratin major të lumit Vardar në një sipërfaqe prej 19.963 m², është përfunduar korsia për rolerë në Aerodrom me rrafshimin e terrenit si dhe me formimin e bankave të dheut në gjatësi prej 1 792 m.

PROJEKTI: NDËRTIMI I TELEFERIKUT DERI TE MAJA E VODNOS

Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Ministrinë e transportit dhe lidhjeve filloi procedurën për realizimin e këtij projekti – në rrjedhë është thirrja publike për furnizime publike lidhur me projektimin e tel-eferikut me kabinë njërrjetëshe për transportimin e personave në trajektore rrethore në drejtimin Shkup – Vodno.

PROJEKTI: SHKUPI I PASTËR

Prej 11 majit deri më 18 qershor u realizua aksioni i parë “Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbëruar”. Rezultatet janë imponante, ky është vetëm fillimi i një aktiviteti që do të zhvillohet në vazhdimësi e që gjatë katër viteve të ardhshme duhet tërësisht ta arsyetojë moton e saj.

PROJEKTI: BLERJA E KONTEJNERËVE TË RINJ PËR MBETURINA

Në bashkëpunim me Qeverinë e RM-së, deri më tani janë vendosur 600 kontejnerë të rinj për mbeturina dhe pritet arritja e 714 kontejnerëve të tjerë. Në mënyrë plotësuese janë vendosur 150 shporta për mbeturina në Parkun e qytetit.

PROJEKTI: PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË QYTETIN E SHKUPIT

Ka përfunduar projekti për bulevardin “Makedonska Vojska”.

Po përgatitet projekti për rrugën “Bllagoja Stefkovski”.

Është filluar me përgatitjet e furnizimit publik për bashkimin e bul. “Hristijan Todorovski Karposh” me qarkoren.

PROJEKTI: ZGJERIMI I BUL. “PËRVOMAJSKA” PREJ SEMAFORËVE AFËR “USJE” NË DREJTIM TË VENDBANIMIT DRAÇEVË

Në fazë është përgatitja e projektit në dy faza, prej tramit afër “Fidanishtes” dhe prej bul “Serbia” deri në Draçevë kurse paralelisht punohet në zgjidhjen e raporteve pronësore-juridike.

PROJEKTI: ZGJERIMI I BUL. “ILINDEN” PREJ SHATËRVANIT “LULJA E LOTUSIT” NË DREJTIM

TË KARPOSHIT DHE GJORÇE PETROVIT

Po punohet në zgjidhjen e raporteve pronësore-juridike.

PROJEKTI: ZGJERIMI DHE SENDËRTIMI I BUL. “SERBIA”

Pritet që projekti të fillojë me realizimin e tij.

PROJEKTI: NDËRTIMI I BUL. MITROPOLIT TEODOSIJ GOLLOKANOV

Ka përfunduar projekti ideor, për momentin po përpilohet programi projektues.

PROJEKTI: NDËRTIMI I URËS PËR KËMBËSOR DHE TË PARKINGUT

Po përpilohet programi projektues dhe po kompletohet dokumentacioni teknik që të mund të shpallet konkursi publik arkitektonik.

PROJEKTI: VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË KANALIZIMIT TË FEKALEVE PREJ LUMIT VARDAR DERI NË INXHIKOV

Deri në fund të verës do të përfundojë kanalizimi i fekaleve prej lumit Vardar deri në Inxhikovë, me këtë do të zgjidhet problemi shumëvjeçar me të cilin bal-lafaqoheshin rreth 30.000 banorë.

PROJEKTI: BIENALE E ARTISTËVE TË RINJ NGA EUROPA DHE MEDITERANI

Në rrjedhë janë aktivitetet për përgatitjen e Bienales, përkrahja financiare, inkuadrimi i tre institucioneve publike nga fusha e kulturës dhe të ndërmarrjeve publike.

PROJEKTI: QENDRA KULTURORE RINORE

Për realizimin e rekonstruksionit të QKR është përpiluar dokumentacioni projektues dhe duhet të fillojnë përgatitjet për realizimin e të njëjtës.

PROJEKTI: PËR TË BUKURËN (Dëgjo muzikë, shiko fotografi, fito libër)

Nën moton: „Shiko muzikë, dëgjo fotografi, fito libër”, më 18 qershor u mbajt koncerti tradicional multimedial i Filarmonisë maqedonase e titulluar si “Tani - art”, kurse të pranishmëve u ndanë 20.000 ekzemplarë të veprës „Novela për ëndrrën” nga Artur Shnicler.



PROJEKTI: REVITALIZIM DHE POPULLARIZIM I ÇARSHISË SË VJETËR TË SHKUPIT SI ATRAKSION TURISTIK

Nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim janë ndarë 1.8 milion denarë.

PROJEKTI: RREGULLIMI I MATKËS DHE ZHVILLIMI I TURIZMIT EKOLOGJIK

Janë bërë projekte për korsi të nga shpella Vrelo deri Krshtelna dhe Ubava, si dhe korsi nga Shën. Andrea deri te manastiri "Sv. Nedela", rregullimi i shpellës Vrelo dhe projekti për vendosjen e rrethimit mbrojtës nga pyka deri në Kodrën e lartë 4 km (shpella, burimi Vrelo). Projekti për urë të varur, tre parkingje dhe muzeu i shkencave natyrore.

PROJEKTI: NDËRTIMI I SHKOLLËS SË MESME NË KOMUNËN SHUTO ORIZARI

Në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit është miratuar Propozim-Konkluzioni për dhënien për krahe-pëlqim për ndërtimin e objektit shkollë e mesme në rr. Çe Gevara dhe në rr. Uashingtonska.

PROJEKTI: MARATONI ÇIKLISTIK SHKUP

Përgatitje për mbajtjen e garës së parë çiklistike natën, me rastin e 13 Nëntorit.

PROJEKTI: LIGA E SHKOLLAVE TË MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT

Është themeluar shoqatë civile "Lidhja e sportit shkollor të shkollave të mesme të Shkupit", në të cilën marrin pjesë profesorë të kulturës fizike të shkollave të mesme në territorin e Shkupit, drejtorë të shkollave të mesme dhe punëtorë të tjerë sportivë. Kjo shoqatë do të formojë Lidhjen e shkollave të mesme, ndërsa garat duhet të fillojnë në tetor të viti 2009.

PROJEKTI: PROGRAMI PËR PROMOVIMIN E NGJARJEVE TË RËNDËSISHME DHE PERSONALITETEVE NGA FUSHA E ARSIMIT

Janë iniciuar shkollat e mesme të dorëzojnë propozime për shënimin e ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme, ndërkohë që Sektori për arsim do të deklarohet me propozimet e tij.

PROJEKTI: PENGIMI I DHUNËS DHE PËRMIRËSIMI I SIGURISË NË SHKOLLA

Përgatitje për realizimin e projektit në fillimin e vitit shkollor 2009/2010

PROJEKTI: NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME NË PËRMIRËSIMIN E SHËNDETIT DHE AMBIENTIT JETËSOR

Përgatitje për realizimin e projektit në fillimin e vitit shkollor 2009/2010

PROJEKTI: NDËRTIMI SALLËS SPORTIVE PËR FIZIKULTURË NË KORNIZAT E SHKOLLËS SË MESME "ZEF LUSH MARKU"

Po bëhen përgatitjet e fundit për ndërtimin e sallës sportive të fizikulturës në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit "Zef Lush Marku". Në bashkëpunim me Qeverinë e R. së Maqedonisë, do të ndërtohet salla me sipërfaqe prej 1300 metër katror.

PROJEKTI: STUDIME HULUMTUESE PËR NEVOJAT SPECIALE TË NXËNËSVE

Në muajin shtator do të realizohet procedura për furnizimin me studime.

PROJEKTI: AKTIVITETE NGA BASHKËPUNIMI NDERKOMBËTAR I SHKOLLAVE TË MESME

(Bashkëpunimi i nxënësve të shkollave të mesme Shkupit me nxënës të shkollave të mesme nga RUBE, FRANCË dhe TEMPI, SHBA)

PROJEKTI: ANGAZHIMI I ZJARRFIKËSVE TË RINJ

Deri në fund të vitit në Brigadën për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit, do të punësojnë 25 zjarrfikës.

PROJEKTI: PËRGATITJA E PLANIT HAPËSINOR PËR RAJONIN E SHKUPIT

Janë emëruar përfaqësues nga Qyteti i Shkupit që do të përfshihen në përgatitjen e planit hapësinor.

PROJEKTI: RINOVIMI I FASADAVE NË TERRITORIN QENDROR TË QYTETIT

Po kontrollohet statusi i objekteve në lidhje me shkallën e mbrojtjes që të mund të fillohet me përgatitjen e projektit për restaurim-konservim.

PROJEKTI: NDËRTIMI I KORSIVE PËR KËMBËSORË NË TË DY ANËT E VARDARIT

Në kontinuitet po punohet në përfundimin e korsive të filluara dhe paralelisht janë dhënë kërkesa për furnizime publike me projekte të reja (Igj. Aerodrom dhe Igj. Gjorçe Petrov)

PROJEKTI: ADAPTIMI I KORSIVE PËR KËMBËSORË NË VARDAR PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA

Është filluar procesi i tenderit për zgjedhjen e projektit të korsive qasëse.

PROJEKTI: NDËRTIMI I

KALIMEVE NËNTOKËSORE

Po bëhet analiza e infrastrukturës ekzistuese nëntokësore të traseve të dhëna (deri tani janë marrë të dhëna nga Ujësllësi dhe Gama). Janë parashikuar kalime nëntokësore në këto lokacione: bul. Maqedonia; bul. Partizanski odredi (tek Fakulteti arkitektonik), bul. Partizanski odredi (afër QT Karposh 3), bul. Kërste Misirkov (në Bit Pazar), bul. A. Makedonski (tek Alkaloid), bul. Jane Sandanski (tek QT Biser). Pas evaluimit të infrastrukturës nëntokësore do të fillohet me përgatitjen e zgjidhjeve ideore.

PROJEKTI: BULEVARDI MAQEDONIA-RRUGË NËNTOKËSORE

(pas Ramstor)

Është filluar procedura Komuna Qendër të dorëzojë bazën teknike-dokumentuese për realizimin e projektit rrugë nëntokësore në bulevardin Maqedonia.

PROJEKTI: URË E RE PËR KËMBËSORË

(tek QTO)

Përgatitet program dhe po kompletohet dokumentacioni teknik që të mund të bëhet konkurs arkitektonik anonim publik.

PROJEKTI: KOLEKTOR FEKAL NGA NOVO LISIÇE

Është shpallur tender për projektin për kolektor fekal. Së shpejti do të fillohet me realizimin e projektit.

PROJEKTI: LËSHIMI NË PËRDORIM I UJËSJELLËSIT NË KOMUNËN SHUTO ORIZARI

Është lëshuar në përdorim ujësllësi në Komunën Shuto Orizari, me të cilin zgjidhet problemi i furnizimit me ujë për një numër të madh qytetarësh të kësaj komune.

PROJEKTI: EFIKASITETI ENERGJETIK

Është përfunduar me procedurën për zgjedhjen e realizuesit më të volitshëm për përgatitjen e studimit për Efiikasitet energjetik në territorin e Qytetit të Shkupit për një periudhë pesë vjeçare.

PROJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I NDRIÇIMIT PUBLIK

Filloi zëvendësimi i 3100 llambave ndriçuese për ndriçim publik me të cilat do të sigurohet zvogëlimi i energjisë elektrike të harxhuar në masën 35%.

PROJEKTI: VENDOSJA E NUMËRATORËVE NË SHTYLLAT E NDRIÇIMIT PUBLIK

Në rebalancin e buxhetit janë parashikuar mjete për vendosjen e numërorëve në të gjitha shtyllat e ndriçimit publik që janë nën kompetencat e Qytetit të Shkupit.



PROJEKTI: NDËRTIMI I NDRIÇIMIT TË RI PUBLIK

Në fazën përfundimtare është ndërtimi i ndriçimit publik në bul. Vedoe Smilevski Bato dhe në rrugët e reja të projektuara në lagjen Juria. Është parashtruar kërkesë për furnizim publik të projektit për ndërtimin e ndriçimit publik në udhëkryqin Kombinati i duhanit, qasje në rrugën e objektit në rrugën Salvador Aljende dhe në rrugën Maxhari, në vijim është përgatitja e projektit për ndërtimin e ndriçimit publik në bulevardin Serbia dhe në rrugën Përvomjavska.

PROJEKTI: PASTRIMI I DEPOVE TË EGRA

Në mënyrë makinerike janë pastruar 200 m³ mbeturina ndërtimore dhe hedhurina nën Qendrën transportuese dhe 1500 m³ në komunat e qytetit.

PROJEKTI: MENAXHIMI ME MBETURINAT

Ka përfunduar procedura për zgjedhjen e realizuesit më të leverdishëm për përgatitjen e studimit për Plan për menaxhimin me mbeturinat në territorin e Qytetit të Shkupit për periudhë katër vjeçare.

PROJEKTI: FURNIZIMI ME PESË AUTOMJETE DHE MAKINA PËR NP "PARQE DHE GJELBËRIM"

Janë hapur ofertat, në vazhdim do të bëhet vlerësimi dhe zgjedhja e ofertave më të leverdishme pas së cilës do të vijojë blerja e automjeteve.

PROJEKTI: NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I TOALETËVE PUBLIK (në bashkëpunim me Ministrinë për transport)

Ka filluar procedura për furnizim publik për zgjedhjen e realizuesit më të leverdishëm të punëve për ndërtimin e toaletëve në pjesën e dytë të Parkut të qytetit dhe rikonstruksionit të toaletëve ekzistues në pjesën e parë të parkut dhe nën urën Goce Dellçev.

PROJEKTI: PËRKUJDESJE PËR QENËT E RRUGËS

Është bërë furnizimi me pajisje të reja për gjunjatjen dhe trajtimin human të qenve endacak dhe po realizohet edhe procedura për furnizimin me automjete për transportimin e tyre.

PROJEKTI: LICENCIMI I TRANSPORTUESVE NË TRAFIKUN URBAN

Në procedurë është përgatitja e konkursit për marrjen e linjave të transportit publik urban për territorin e Qytetit të Shkupit.

PROJEKTI: PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I KORSIVE PËR BIÇIKLETA NË QYTETIN E SHKUPIT

Ka përfunduar korsa për biçikleta prej bulevardit Serbia deri tek Qendra transportuese, në

procedurë është vendosja e parkingjeve për biçikleta në TQO, vendosja e sistemit për huazimin (rent – a bike). Është nënshkruar kontratë për NICHE+ projektin me UE në të cilin do të punohet në fushën e objekteve inovative për biçikleta në qendrat transportuese intermodale.

PROJEKTI: STREHA PËR STACIONET PUBLIKË TË AUTOBUSËVE

Në procedurë është procedura për furnizim publik të elaboratit për përcaktimin e mikrolokacioneve të stacioneve të autobusëve dhe tabelave informative për informimin e udhëtarëve.

PROJEKTI: VENDOSJA E VALËVE TË GJELBRA NË RRUGËT MË TË FREKUENTUARA NË QYTET

Në procedurë është vendosja e valëve të gjelbra në bulevardin Goce Dellçev nga Panairi i Shkupit deri tek udhëkryqi tek TKM.

PROJEKTI: KOMPJUTERIZIMI I SEMAFORËVE ME VIDEO MBIKËQYRJË DHE SINJALIZIM RRUGOR

Në rrjedhë është procedura për shpalljen e tenderit për: pajisje inteligjente eksterne RSU për kontroll, për përgatitjen e projektit dhe instalimin e kabllove optike dhe për incizimin e komunikacionit në TQO në Shkup.

PROJEKTI: VENDOSJE E SINJALIZIMIT VERTIKAL

Në procedurë është përgatitja e dokumentacionit tenderik për vendosjen e tabelave udhërrëfyese dhe sinjalizimit turistik në Shkup.

PROJEKTI: VAZHDIMI ME PARKIMIN NË ZONA

Projekti ka përfunduar tërësisht dhe së shpejti do të fillojë implementimi i tij.

PROJEKTI: AKTIVITETE NË FUSHËN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Aktivitetet të Qytetit të Shkupit në organizatat ndërkombëtare, asociacione dhe rrjete të qyteteve.

PHILIA – Asociacion i qyteteve multietnike – konferencë vjetore – Organizim të pjesëmarrjes në konferencën e cila u mbajt në Sarajevë në periudhën 3-5.07.2009.

Unioni i kryeqyteteve të Evropës Qendrore dhe Juglindore – konferencë vjetore – Organizim të pjesëmarrjes në konferencën që do të mbahet në Vjenë në periudhën 11-13.11.2009.

Aktivitetet të Qytetit të Shkupit me qytetet e vëllazëruara.

Manisë – Festivali Mesir që u mbajt në fund të muajit prill 2009 – Pjesëmarrje e Qytetit të Shkupit me program të pasur kulturor artistik.

Lubjana: Vizitë zyrtare e delegacionit nga

Shkupi e prirë nga kryetari i qytetit Koce Trajanovski të qytetit të Lubjanës.

Nyrnberg – Gjermani, ekspozitë dhe qëndrim studimor i artistëve – qëndrim i artistes Ursulla Jungs në periudhë 1 mujore, ekspozitë e artistëve të Nyrnbergut e cila është hapur në ditën e hapjes së manifestimit "Vera e Shkupit".

Tempi, Arizona (SHBA), shkëmbim i nxënësve të shkollave të mesme – Qëndrim të katër nxënësve të këtij qyteti të vëllazëruar në Shkup në periudhë prej pesë javë në familje të nxënësve, pas të cilës do të kemi qëndrim të nxënësve të Shkupit në Arizona.

PROJEKTI: BASHKËPUNIMI ME SEKTORIN CIVIL

Fond i veçantë për financimin e projekteve të OJQ.

Thirrje publike për financimin e projekteve dhe aktiviteteve të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2009.

– në rrjedhë është procedura e shpalljes.

Formimi i Qendrës - OJQ – Definim i hapësirës dhe lokalitetit të OJQ – qendrës (është zgjedhur hapësirë adekuate dhe lokaliteti i OJQ – qendrës në hapësirat e lira të QKR). – Planifikohet hapësira të rikonstruohet deri në fund të shtatorit 2009.

Forum i OJQ të Qytetit të Shkupit – Plan i definuar aksionar për vitin 2009 – Përbërje e rikomponuar me anëtarë të rinj nga Komisioni për bashkëpunim me komunat dhe OJQ të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Projekte evropiane në të cilat Qyteti i Shkupit është partner.

RENAISSANCE - zbatim i konceptit bashkëkohor për zhvillim urban në fushën e komunikacionit – Projekt i financuar nga UE në kuadër të programit të 7-të kornizë.

NICHIE+ – Projekt i financuar nga UE në kuadër të programit të 7-të kornizë, me qëllim promovimin e masave inovative për transport urban më efikas dhe të qëndrueshëm në qytetet (Kontratë e nënshkruar për pjesëmarrje në projekt dhe fillim të realizimit).

"Forcimi i kapacitetit për menaxhim efikas me energjitë të qyteteve" – Projekt regional në të cilin janë përfshirë dhe qytetet Zagreb, Sarajevë dhe Podgoricë, i financuar nga GT3 përmes Fondit të hapur regional – Efikasiteti energjetik në Evropën juglindore (kontratë e nënshkruar për pjesëmarrje në projekt dhe fillim i realizimit).

Këto janë pjesë e projekteve të cilat kanë filluar në 100 ditët të para kurse të tjerat që nuk janë në këtë listë janë në lajmëtarin informativ të qytetit, si foto-storie.



SUKSES I MADH I AKSIONIT “SË BASHKU PËR SHKUPIN E PASTËR DHE TË GJELBËR”

Aksioni i madh për pastrimin e Shkupit nën moton “Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbër” u realizua me sukses të madh. Aksioni, i iniciuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, u realizua në bashkëpunim me dhjetë komunat e Shkupit. Ekipet e ndërmarrjeve publike të qytetit “Higjiena komunale”, “Parqe dhe gjelbërim”, “Ujësjellës dhe kanalizim” dhe “Rrugë dhe rrugica” u mobilizuan dhe u angazhuan në mënyrë maksimale për pastrimin e Shkupit.

- Qëllimi ynë është ta pastrojmë Shkupin, por edhe të ngremë vetëdijen te qytetarët ta ruajnë dhe të kujdesen për ambientin në të cilin jetojnë. Qëllimi ynë është që qytetarët ta ndjejnë këtë aksion si të vetin dhe të kontribuojnë për një ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm — theksoi kryetari Koce Trajanovski, në fillim të aksionit.

Gjatë kohës së aksionit i cili zgjati nga 11.05 deri më 18.06. 2009, në territorin e dhjetë komunave të Shkupit u kosit bari, u krasitën dru, u prenë drurët e thatë, u pastruan depot e egra, u fshinë dhe u lanë rrugët dhe u fshinë vend grumbullimet.

Në aksion, sipas komunave u mbledhën këto sasi mbeturinash:

Komuna Gazi Baba

- U mbledhën 178 metër kub mbeturina komunale;
- U kosit bari në një sipërfaqe prej 60.000 metër katror;
- U fshinë dhe u lanë në mënyrë manuale dhe me makineri 26 rrugë;
- Janë ngritur mbeturina nga amvisëritë me vëllim prej 28 metra kub;
- Janë prerë dhe krasitur 20 drurë;

Komuna Qendër

- Janë mbledhur 64 metër kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej

74.700 metër katror, ndërsa në një sipërfaqe prej 200 metër katror janë mbjellur lule;

- Janë ngritur mbeturina nga amvisëritë me vëllim 12 metër kub;
- Janë vendosur 26 kontenier të rinj;
- Janë prerë 19, dhe janë krasitur 6 drurë

Komuna Çair

- Janë mbledhur 156 metër kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 47.629 metër katror;
- Janë fshirë dhe larë në mënyrë manuale dhe me makineri rrugët e qytetit;
- Janë pastruar në mënyrë manuale derdhjet në 6 rrugë dhe pusetat në 3 rrugë me cisterna nën vakum;
- Janë vendosur 28 kontejnerë të rinj;



- Janë të krasitur 25 drunj dhe janë prerë 4 drunj.

Komuna Gjorçe Petrov:

- Janë mbledhur gjithsej 163 metro kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 44.000 metro katror.
- Janë pastruar pusetat në 14 rrugë, kurse në shatërvanin e parkut "Gjorçe Petrov" puseta është pastruar me kavo;
- Në mënyrë manuale dhe makinerike janë pastruar dhe larë më shumë rrugë në territorin e komunës;
- Janë vendosur 41 kontejnerë të rinj;
- Janë krasitur 80 drunj kurse janë prerë 14 drunj.

Komuna Aerodrom

- Janë mbledhur 172 metro kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 92.000 metro katror;
- Në mënyrë manuale dhe makinerike janë pastruar dhe larë më shumë rrugë në territorin e komunës;
- Janë pastruar pusetat, në mënyrë manuale dhe me cisterna nën presion;
- Janë vendosur 40 kontejner të rinj;
- Janë krasitur 90 drunj kurse janë prerë 31 drunj;

Komuna Butel

- Janë mbledhur 113 metro kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 57.000 metro katror;
- Janë pastruar pusetat, në 9 rrugë dhe është

kryer kontroll dhe pastrim të kanalizimit fekal dhe atmosferik në 2 rrugë;

- Në mënyrë manuale dhe makinerike janë pastruar dhe larë më shumë rrugë në territorin e komunës;
- Janë vendosur 33 kontejner të rinj;
- Janë krasitur 52 drunj kurse janë prerë 8 drunj.

Komuna Karposh

- Janë mbledhur 202 metro kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 52.600 metro katror;
- Janë pastruar pusetat në 11 rrugë;
- Janë pastruar dhe larë kanale atmosferike në 17 rrugë të komunës;
- Janë vendosur 46 kontejner të rinj;
- Janë krasitur 32 drunj kurse janë prerë 7 drunj.

Komuna Saraj

- Janë mbledhur 165 metro kub mbeturina komunale;
- Në mënyrë manuale dhe makinerike janë pastruar dhe larë më shumë rrugë në territorin e komunës;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 51.000 metro katror;
- Janë krasitur 15 drunj;

Komuna Kisella Voda

- Janë mbledhur 50 metro kub mbeturina komunale;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 42.000 metro katror;
- Në mënyrë manuale dhe makinerike janë pastruar dhe larë më shumë rrugë në ter-



ritonin e komunës;

- Janë pastruar dhe larë kanale atmosferike dhe të fekaleve në 7 rrugë të komunës kurse pusetat janë pastruar me cisternë me presion vakumi në 9 rrugë;
- Janë vendosur 10 kontejner të rinj;
- Janë krasitur 58 drunj kurse janë prerë 6 drunj.

Komuna e Shuto Orizares

- Janë mbledhur 341 metro kub mbeturina komunale;
- Janë vendosur 35 kontejner të rinj;
- Është kositur bari në një sipërfaqe prej 20.000 metro katror;
- Në mënyrë manuale është pastruar rrjeti i kanalizimit në 9 rrugë kurse në katër rrugë me ndihmë të cisternës nën presion është pastruar rrjeti i kanalizimit;
- Janë vendosur 35 kontejner të rinj;
- Janë krasitur 4 drunj;



KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT TRAJANOVSKI NË TAKIME ME QYTETARËT



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski në periudhën prej 22 qershor deri më 03 korrik të vitit 2009 i vizitoi 10 komunat në qytetin e Shkupit me ç'rast realizoi takime me përfaqësuesit e bashkësive vendore me qëllim që të njoftohet prej së afërmi me problemet që i tangojnë qytetarët. Gjatë takimeve në komunat ishin të pranishëm edhe drejtorët e ndërmarrjeve publike të qytetit si dhe përfaqësues të administratës së qytetit.

Kryetari Trajanovski theksoi se qëllimi i këtyre takimeve është zmadhimi i bashkëpunimit në mes bashkësive vendore, pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve publike përmes implementimit të sistemit të ri të punës si dhe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohen.

Gjatë këtyre takimeve, kryetarët e bashkësive vendore i njoftuan përfaqësuesit e administratës së Qytetit dhe të ndërmarr-

rjeve publike me problemet me të cilat ato ballafaqohen në përditshmërinë e tyre dhe dhanë propozime lidhur me atë se si mund të tejkalohen të njëjtat.

Kryetari Trajanovski, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike si dhe administrata e Qytetit premtoan se në periudhën e ardhshme do t'i zmadhojnë përpjekjet për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët.



PAMJE E RE NË PARKUN E QYTETIT



- Janë vendosur 100 shporta të reja për mbeturina në pjesën e parë të Parkut të qytetit si dhe 50 shporta për mbeturina në pjesën e dytë të parkut;
- Është realizuar riparimi dhe bojatisja e ulëseve në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit;
- Janë prerë drunjtë e vjetër dhe të tharë që cenonin sigurinë e kalimtarëve;
- Janë prerë degët dhe janë krasitur drunjtë;
- Janë mbjell bordura të reja prej luleve, janë mbjell trëndafilë dhe lule të tjera sezonale;
- Janë vendosur shtyllëza dhe trame që të pengohet hyrja e automjeteve në Parkun e qytetit;
- Është vendosur rërë e bardhë në pjesën e parë të Parkut të qytetit;
- Është realizuar pastrimi i liqeneve në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit.



PASTRIM I MADH I SHTRATIT TË LUMIT VARDAR



Aksioni i madh për pastrimin e shtratit të lumit Vardar, të cilin së bashku e realizojnë Qyteti i Shkupit, Ministria për transport dhe lidhje dhe komunat e Shkupit filloi më 1 korrik 2009 me pastrimin e shtratit të urra në Saraj. Aksioni për pastrim do të zgjatë deri në gusht dhe sipas nevojës do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme. Ekipet e Qytetit të Shkupit maksimalisht janë angazhuar në pastrimin e shtratit minor dhe major të lumit Vardar.



KOLEKTOR TEK PIKËLIDHËSJA "KONTINENTAL"



Ekipet e Qytetit të Shkupit e filluan zgjerimin e sistemit kolektor për ujëra atmosferik në pikëlidhësen tek hoteli "Kontinental", pasi u konstatua se kolektori ekzistues atmosferik është me kapacitet më të vogël për mbledhjen e sasive më të mëdha të ujit. Rikonstruksioni i sistemit realizohet në faza dhe tani më është vendosur kolektor atmosferik plotësues me diametër prej 600 milimetra në pjesën tek hoteli "Kontinental".



SHËNIM I RRUGËVE TË QYTETIT GJATË NATËS



Qyteti i Shkupit për herë të parë filloi me shënim natën të sinjalizimit horizontal në rrugët dhe bulevardet e qytetit. Ekipet e Qytetit të Shkupit në periudhën e kaluar i shënuan rrugët automobilistike në territorin e qendrës së qytetit edhe atë në periudhën prej orës 22 deri në orën 05 të mëngjesit, për shkak të frekuencës më të vogël të komunikacionit. Rrugët dhe bulevardet janë shënuar në mënyrë mekanike dhe makinerike me ngjyrë të bardhë.





330 PUNËTORË SEZONAL

Treqind e tridhjetë punëtorë të angazhuar nga Qyteti i Shkupit përmes projektit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për punësim të përkohshëm të personave papunë për kryerjen e punëve publike janë kyçur në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe të higjienës në qytet.

Në drejtim të përmirësimit të higjienës komunale dhe pastërtisë publike, Qyteti i Shkupit vendosi 460 kontejnerë të rinj për mbeturina nëpër komunat e Shkupit. Kontejnerët e rinj janë donacion i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë i realizuar përmes Ministrisë për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor.

Qyteti me këtë projekt do të fitojë gjithsej 1314 kontejnerë për mbeturina të cilët do të shpërndahen nëpër komunat e Shkupit.



Kontejnerë të rinj për Shkupin

VERË PA ZJARRE



Qyteti i Shkupit dhe Ministria për punë të brendshme filluan projekt të përbashkët për mbrojtjen e gjelbërimit nga zjarret e titulluar "VERË PA ZJARRE".

Projekti është orientuar drejt ngritjes së ndërgjegjes së qytetarëve për parandalimin dhe për mënyrat e përballjes me zjarret në pyje që janë më të shpeshta në periudhën verës.





Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, bashkë me kryetarin e Komunës Aerodrom, Ivica Konevski, lëshuan në përdorim terminalin e NQP për linja 5 dhe 15, në Igg. Novo Lisiçe.

- Me këtë projekt do të mundësohet qasje e pandërprerë deri në rrugë, ndërsa stacioni i fundit aktual i linjave 5 dhe 15, do të kalojë në terminal, duke zgjidhur kështu një problem shumëvjeçar të qytetarëve të kësaj lagjeje – tha kryetari Trajanovski gjatë lëshimit në përdorim të terminalit në Igg. Novo Lisiçe.



Janë vendosur hidrantë të rinj në më shumë lokacione nëpër qytet që të sigurohet standard më i lartë dhe mobilitet më i madh i ekipeve të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit.



Është asfaltuar bulevardi Goce Delçev në pjesën para Televizionit të Maqedonisë.



Qyteti i Shkupit dhe NP "Higjiena komunale" për të përmirësuar efikasitetin e seleksionimit të mbeturinave, bënë furnizimin me presë hidraulike të përdorur, me të cilën do të kryhet presimi i plastikës së mbledhur. Presa bashkëkohore është me kapacitet më të madh dhe me teknologji më të sofistikuar se sa presa e deri tanishme në oborrin për riciklim.



Në kornizat e aktiviteteve për freskimin dhe rregullimin e sipërfaqeve publike, ekipet e Qytetit të Shkupit lyen rrethimet në urën Goce Delçev, ndërsa më parë u lyen edhe rrethimet e urave të Banka Popullore dhe tek hoteli Holidej In.



Në aksionin e organizuar nga Qyteti i Shkupit është pastruar hapësira nën Stacionin hekurudhor drejt lumit Vardar nga mbeturinat dhe depot e egra, ndërkohë që është pastruar edhe e ashtuquajtura mëhalla e kartonit.

Ekipet e Qytetit të Shkupit me mekanizim ngritën hedhurina, mbeturina ndërtimore dhe materiale të tjera me vëllim prej 166 metër kub.

Janë vendosur 38 numërorë semafori të rinj në më shumë lokacione të bulevardit Partizanski odredi.



Ekipet e Qytetit të Shkupit e rinovuan vend vrojtimi në QRS "Liqeni Treska" dhe ndërtuan edhe një vend rekreimi të ri.

Në lulishtet janë vendosur 15 tavolina me 35 stola për t'u ulur, kurse 15 stola janë vendosur anës korsisë rreth liqenit.

Në QRS "Liqeni Treska" janë rinovuar edhe nyje sanitare, janë bërë riparime të instalimit elektrik, ndërsa janë vendosur dhe bojler dhe bateri për dush.





Ndërtimi i kanalizimit fekal prej vendbanimit Inxhikovë deri te lumi Vardar, në komunën e Gazi Babës. Këtë projekt, Qyteti i Shkupit e realizon në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Me realizimin e këtij projekti do

të zgjidhet problemi me kanalizimin fekal dhe pjesërisht edhe me kanalizimin atmosferik për rreth 40.000 qytetarë prej më shumë vendbanimeve në Komunën e Gazi Babës, siç janë vendbanimet Hasanbeg, Çento, Hipodrom, Maxhari dhe Inxhikovë.



përfshiu: zëvendësimin e mureve shtyllë mbajtëse; zëvendësimin e korsive për këmbësorët; rregullimin e gjelbërimit; krasitjen dhe mënjanimin e gjelbërimit të egër; janë të vendosura 4 ulëse, 2 tryeza dhe 24 shporta për mbeturina në vend vrojtimin në pjesën e sipërme dhe 3 shporta për mbeturina në vend vrojtimin në pjesën e poshtme; janë bojatisur dhe rregulluar rrethojat; është bojatisur kulla metalike trigonometrike; është rregulluar sinjalizimi horizontal dhe vertikal si dhe janë vendosur tabelat informuese.

Në suaza të aktiviteteve të parapara në programit të Kryetarit të Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski për rregullimin e park-pyllit Vodno, në muajin e kaluar ekipet e Qytetit të Shkupit realizuan rekonstrukcion të tërësishëm të dy vend vrojtimeve në Vodno.

Rekonstrukcioni i dy vend vrojtimeve

Dy vend vrojtimit në Vodno janë ndërtuar në vitin 1969, një kohë të gjatë ato ishin në një gjendje të braktisur dhe të rrënuar. Viteve të fundit qasja e qytetarëve deri te ato ishte pothuajse e pamundshme kurse vend vrojtimit në pjesën e sipërme ishte e mbyllur me bankinë.

Me rekonstrukcionin e kryer, dy vend vrojtimit sërisht do të jenë në qasje për qytetarët dhe në këtë mënyrë do t'u mundësohet edhe një hapësirë për rekreacion me një pamje panoramike të qytetit të Shkupit.



Ekipet e Qytetit të Shkupit gjatë dy javëve të fundit zëvendësuan 1.340 llamba elektrike në 26 rrugë të komunikacionit.

Me projektin e lartpërmendur parashikohet zëvendësimi i mbi 3.000 llambave elektrike në 60 rrugë të komunikacionit dhe gjatë kësaj do të sigurohet ndriçim më cilësor dhe kursim të energjisë elektrike për rreth 30%.



Janë furnizuar pajisje të reja për kapjen e qenve endacak në stacionarin "Vardarishte". Janë furnizuar 10 kafaze të reja që do të shfrytëzohen gjatë kapjes dhe transportimit të qenve, 10 kurthe të reja për kapjen e qenve, 3 kurthe silikon për kapjen e qenve, 3 rrjete me qafore si dhe 3 rrjete me dorëza. Këto pajisje do t'i zëvendësojnë pajisjet e vjetra që tani më janë të amortizuara dhe me efikasitet më të vogël. Të punësuarit në stacionarin u përfituan me trajnime të posaçme që kishte të bëjë me përdorimin e këtyre pajisjeve.



MUZIKANTË DHE VALLËZUES TË RRUGËS

Vallëzim në rrugë, muzikë në ambient të hapur dhe pantomima – këto janë vetëm një pjesë e përmbajtjeve zbavitëse në të cilat shkupjanët do të kënaqen gjatë verës në katër lokalitete të qendrës së qyteti. Shfaqet në ambient të hapur janë pjesë e projektit pilot me titull “Muzikantë dhe vallëzues të rrugës – zbavitës”, të cilat këtë verë i realizon Qyteti i Shkupit.



U ZHVILLUA KOLONIA
NDËRKOMBËTARE
E ARTIT FIGURATIV
“SHKUP 2009”

BACKERFEST 2009

Akrobatë, magjistarë, pantomistë, zhonglerë, muzikantë, performancë me kukulla, nga Maqedonia dhe nga jashtë, zbavitën shkupjanët në kuadër të manifestimit “BACKERFEST 2009”. Manifestimi është nën patronazh të Qytetit të Shkupit dhe në organizim të Shoqatës së qytetarëve “ONE WAY”.



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski në mënyrë solemne e hapi manifestimin “VERA E SHKUPIT 2009”



KUVENDI THEMELUES I LIDHJES SË SPORTEVE SHKOLLORE TË SHKOLLAVE TË MESME NË QYTETIN E SHKUPIT

Në iniciativë të Qytetit të Shkupit u mbajt kuvendi themelues i shoqatës qytetare – “Lidhja e sporteve shkollore të shkollave të mesme në qytetin e Shkupit”, që për qëllim do të ketë popullarizimin e sportit në mesin e të rinjve, përmes formimit të ligave të shkollave të mesme për një numër të madh të disiplinave sportive.

Është promovuar „Udhërrëfyesi turistik - SHKUPI“. Përmbajtjet e udhërrëfyesit shpalosen në 144 faqe, të fisnikëruara me fotografi, tekste dhe harta. Udhërrëfyesi është i përpiluar në dy gjuhë, në gjuhën maqedonase dhe atë angleze.



Kryetari i Qytetit të Shkupit gjatë takimit me udhëheqësin e Lidhjes së shoqërive të pensionistëve të Qytetit të Shkupit nënshkroi Marrëveshje për bashkëpunim.

Me Marrëveshjen konkretizohen çështjet të cilat gjatë periudhës së ardhshme në mënyrë permanente do të realizohen në interes të këtij grupi social por edhe në interes të Qytetit të Shkupit.



Në iniciativë të Kryetarit të Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski si dhe të Lidhjes së odave ekonomike, Odës rajonale me seli në Shkup si dhe Odës ekonomike të Maqedon-

isë Veri-Perëndimore, më datë 23.06.2009 u mbajt punëtori e bashkësisë afariste me komunat në qytetin e Shkupit.

Temat kryesore në punëtorinë ishin prezantimi i Planeve të detajuara urbanistike të komunave si dhe potencialet për investime, si dhe problemet me të cilat ballafaqohen afaristët gjatë funksionimit në fushëveprimin e administratës shtetërore dhe lokale, kadastrat e pronave të paluajtshme.

Nëseancën e dytë të Këshillit të Qytetit të Shkupit, të mbajtur më 28.05.2009, u soll vendimi me të cilin u formuan 21 komisione si trupa ndihmëse për punën e Këshillit të Qytetit të Shkupit.



Çdo të premte të fundmuajit, Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski do të realizoj takime me qytetarët dhe gjatë kësaj shkujpanët do të mund të bisedojnë me Kryetarin e Qytetit të Shkupit për problemet me të cilat probleme qytetarët ballafaqohen për çdo ditë e që kanë të bëjnë me fushëveprimin e Qytetit të Shkupit.

Kjo praktikë e ditës së hapur të Qytetit të Shkupit filloi me takimin e parë të qytetarëve me Kryetarin Trajanovski, që u realizua më datë 26.06.2009.



Gjatë muajve të kaluar u mbajtën tre seanca të Trupit koordinues të kryetarëve të komunave të qytetit të Shkupit dhe Kryetarit të Qytetit të Shkupit. Në seancat u diskutua për projekte dhe iniciativa të rëndësishme si dhe për vendimin për punët publike të Qeverisë së

Republikës së Maqedonisë dhe efektit të saj për komunat në territorin e Qytetit të Shkupit, realizimin dhe efektet nga aksioni “Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbëruar” si dhe për çështje të tjera.

